

V E N D I M
Nr.14, datë 15.5.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Manol Konomi,	Anëtari
Feti Gjilani,	Anëtari
Alfred Karamuço,	Anëtari
Veli Budo,	Anëtari
Zija Vuci,	Anëtar i
Franc Jakova,	Anëtari
Hilmi Dakli,	Anëtari

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 13.5.1996 dhe 14.5.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen Nr.20 Akti, që i përket :

K E R K U E S E : PARTIA SOCIAL PUNETORE SHQIPTARE, e përfaqësuar nga Z. Fehmi Luca dhe Fatmir Braka.

PALE E INTERESUAR: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE, i përfaqësuar nga Z. Genci Bektashi.

O B J E K T I :

Mosregjistrimi i kandidaturës për deputet të Z. Bashkim Merkaj në zonën elektorale nr.84 Mallakastër, në bazë të Ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me Ligjin nr.8055, datë 1.2.1996.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Partia Social Punëtoe në zonën 84 Mallakastër ka paraqitur si kandidat të saj Z. Bashkim Merkaj. Për këtë qëllim kandidati në fjalë më datë 25.04.1996 i ka dorëzuar komisionit elektorale të zonës dokumentet e nevojitura dhe konkretisht : kërkesën e Partisë Social Punëtoe, dy kopje të deklaratës të vetë kandidatit, vendimin e komisionit shtetëror për kontrollin e figurës morale dhe listën e zgjedhjeve të nënshkruar nga 470 zgjedhës, sipas formës së kërkuar. Më datë 26.4.1996 në orën 20.30' kandidati është paraqitur në komision, ku ishin kryetari dhe anëtarët e komisionit dhe i është kërkuar kryetarit të pajiseshin me dokumentin e dorëzimit, por nga ana e tij iu tha se nuk ishte i nevojshëm. Për këtë shkak anëtarët e komisionit që ishin përfaqësues të subjekteve elektorale, mbajtën një procesverbal të përbashkët me të cilën vërtetohet dorëzimi i dokumentave të 6 partive pjesëmarrëse ndër të cilët edhe ai i Partisë Social Punëtoe.

Më datë 29.4.1996, partia ankuese u informua nga përfaqësuesi i saj se mungonin dokumentet e kandidatit. Për t'u siguruar më mirë më datë 30.4.1996 u dërgua në zonë sekretari i përgjithshëm i kësaj partie i cili mori përgjigjen se dokumentet mungonin. Për këtë partia iu drejtua Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me një notë të shkruar rekomandë datë 30.4.1996 dhe morën prej tij vetëm një përgjigje gojore, se pranë atij Komisioni nuk ndodheshin të paraqitura dokumentet.

Rrethanat e sipërme i provon me kopjen e procesverbalit datë 26.4.1996, me kopjen e notës datë 30.4.1996, një dëftesë postare si edhe me kopjen e shkresës tjetër drejtuar po Komisionit Qendror nr.18 Prot., datë 26.4.1996 me të cilën i është dërguar lista me 6 emra, ndër të cilët edhe kandidati Bashkim Merkaj.

Gjykata nga të dhënat e sipërme konkludon se dokumentet janë paraqitur dhe mungesa e tyre rrjedh për fajin e komisionit të zonës, duke iu mohuar kështu e drejta ligjore e kandidimit. Për rivendosjen e asaj të drejte, palës ankuese i duhet dhënë mundësia e ribërjes së dokumentave.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 50 të Ligjit Nr.7556, datë 4.2.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me Ligjin

Nr.8055, datë 1.2.1996 , si dhe në bazë të nenit 24 pika 10 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, njëzëri,

V E N D O S I :

Detyrimin e komisionit të zgjedhjeve të zonës nr.84 Mallakastër t'i japë Partisë Social Punëtore një afat të nevojshëm për përgatitjen rishtazi dhe paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar nga neni 13 i Ligjit "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor" dhe si të jenë paraqitur në rregull dhe në afatin e caktuar prej tij, të marrë vendimin përkatës.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot, më datë 15.5.1996